

TË REJA SHKENCORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Përmbajtja

- I. Seminari i të premtës.
- II. Punët kërkimore të sapopublikuara.
- III. Artikuj dhe materiale diskutimi në proces.
- IV. Artikuj, intervista të drejtuesve e punonjësve të Bankës, të botuara në shtypin e përditshëm.
- V. Të ndryshme.

I. SEMINARI I TË PREMTËS

Prezantimi i parë i mbajtur në muajin janar ishte ai i Irini Kallucit, Departamenti i Kërkimeve me temë “Përcaktuesit e marzhit neto të interesave në sistemin bankar shqiptar”. Ky material trajton marzhin neto të interesave si një matës i eficiencës së bankave që operojnë në sistemin bankar shqiptar dhe fokusi kryesor bie mbi identifikimin e faktorëve që ndikojnë në masën e këtij treguesi. Sipas vlerësimeve të bëra për sistemin bankar shqiptar, rezulton se marzhi neto i interesave ndikohet më së shumti nga luhatshmëria e normave të interesit (kryesisht për monedhën euro, atë vendase dhe lehtësisht dollarin), nga niveli i shpenzimeve të veprimtarisë që përgjithësisht ka qenë në rritje, si dhe nga masa e rezervave të detyruara që bankat mbajnë pranë Bankës Qendrore.

Muaji shkurt ka nisur me diskutimin e Holger Kächelein, Drini Imami dhe Endrit Lami mbi temën: “Një pikëpamje e re mbi ciklet politike të biznesit: shpenzimet e individëve në Shqipëri”. Ciklet politike të biznesit lidhen me përdorimin e instrumenteve fiskale dhe monetare

për të nxitur rritjen ekonomike përpara zgjedhjeve, me qëllim impresionimin e votuesve. Nisur nga disa studime për rastin e Shqipërisë, ku dëshmohet për një ekspansion fiskal në periudhën parazgjedhore, autorët analizojnë pritshmëritë e publikut lidhur me rezultatet e zgjedhjeve dhe mënyrën se si këto pritshmëri ndikojnë mbi vendimet e tyre për të shpenzuar, e rrjedhimisht mbi variablat makroekonomikë.

Materiali tjetër i diskutuar në seminar ishte “DEVINPRO - Prezantimi i projektit dhe gjetjet kryesore nga anketa për migrantët” përgatitur nga Nicolaas de Zwager, NEXUS dhe Dr. Ilir Gëdeshi, CESS. Anketa për migrantët konsistonte në rreth 4500 intervista në terren, të realizuara në periudhën e festave të fundvitit, në Shqipëri dhe Kosovë dhe kishte për qëllim njohjen e migrantëve dhe të atyre që përfitojnë nga prurjet e tyre si një segment i veçantë i tregut. Analiza e anketimit tregoi se kontributi i prurjeve financiare të lidhura me migrimin mund të rritet më shumë nëse inkurajohen kursimet dhe investimet dhe se ato, mund

të mbështesin më mirë procesin e zhvillimit ekonomik të vendit.

Të premtën e fundit të muajit shkurt, Elona Dushku, Departamenti i Kërkimeve ka referuar mbi temën “Zhvillimi financiar dhe rritja ekonomike. Rasti i Shqipërisë”. Ky material mori në shqyrtim lidhjen shkak-pasojë midis zhvillimit financiar dhe rritjes ekonomike për rastin e Shqipërisë, duke përdorur testin e *Granger-causality* për pesë tregues të ndryshëm të zhvillimit financiar, bazuar në të dhëna të periudhës 1996-2007. Nga gjetjet empirike të studimit rezultoi se në afatin e gjatë vërtetohet lidhja pozitive midis të gjithë treguesve që matin zhvillimin financiar dhe rritjen ekonomike. Ndërsa, në afatin e shkurtër kjo lidhje nuk është mjaft e qartë, pasi tregues të ndryshëm japin rezultate të ndryshme.

Studimi i parë i muajit mars ishte ai i Altin Tankut dhe Risan Shllakut, Departamenti i Kërkimeve me temë: “Përshtatshmëria e regjimit të shënjestrimit eksplicit të inflacionit në rastin e Shqipërisë”. Ndryshe nga studime të tjera teorike mbi përshtatshmërinë e këtij regjimi në rastin e Shqipërisë, materiali i Tankut dhe Shllakut përqendrohet në një hulumtim empirik të transmetimit të politikës monetare. Qëllimi i tij kryesor është të identifikojë objektivin e ndërmjetëm optimal për kuadrin e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë.

Prezantimi i fundit për këtë tremujor ishte ai i Ilir Vikës, Departamenti i Kërkimeve mbi temën: “Vlerësim i shkaqeve të ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë në tregun valutor”. Bankat qendrore të vendeve me një kurs këmbimi

të luhatshëm përgjithësisht, ndërhyjnë për të reduktuar luhatshmërinë e lartë të tregut valutor ose për të ndaluar çrregullime të mëdha të kursit të këmbimit, por jo për të ndikuar tendencën e tij. Duke përdorur një model Probit, studimi përpiqet të nxjerrë në pah arsyet e ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2000-2007. Objektivi kryesor i studimit është të vlerësojë nëse ndërhyrjet e bankës qendrore kanë qenë eficiente në stabilizimin e kursit të këmbimit, duke reduktuar luhatshmërinë e padëshiruar të tregut dhe duke zbutur ose e kthyer atë në një drejtim të synuar.

Punimi i parë i diskutuar për tremujorin prill – qershor 2009 ka qenë ai i Vasil Zaho, fitues i “Çmimit të Guvernatorit për diplomën më të mirë, 2008”, me temë “Eficienca dhe rritja e produktivitetit të bankave shqiptare”. Studimi përdor analizën e ecurisë së të dhënave për të dalluar midis eficiencës së kostos, të shpërndarjes, të teknikës dhe asaj të shkallës, si dhe një metodë funksioni në distancë për të llogaritur indekset e produktivitetit Malmquist, për 12 banka shqiptare, gjatë periudhës 1999-2006.

Në muajin maj, Murat Karagoz, profesor në Universitetin “Epoka”, prezantoi studimin “Disa mendime mbi recesionin e fundit të viteve 2000”. Megjithëse, janë bërë disa krahasime midis recesionit të fundit të viteve 2000 dhe Depresionit të Madh të vitit 1929, ende mbeten ndryshime të mëdha ndërmjet këtyre dy situatave. Në ndryshim nga Depresioni i Madh, integrimi i sotëm i tregjeve financiare globale solli sinkronizim të recesioneve, duke bërë që faza rënëse e tyre të ishte më e ashpër dhe rigjallërimi më i ngadaltë.

Prezantimi i tretë për këtë tremujor ishte ai i Arjan Kadareja, anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, me temë “Variablat financiarë dhe realë për vendet e Eurozonës me lidhje ndërkombëtare. Një metodë VAR globale.”. Studimi sjell një vlerësim sasior të efekteve të goditjeve (në nivel vendi ose global) mbi një numër variablash ekonomike të ShBA, Mbretërisë së Bashkuar dhe vendeve të Eurozonës. Këto të fundit analizohen të veçuara nga njëra-tjetra, për të treguar sjelljen asimetrike të ekonomive të ndryshme ndaj krizës aktuale.

Studimi i rradhës i diskutuar në Seminarin e të Premtes ishte ai i zj. Elona Dushku, Departamenti i Kërkimeve me temë “Gap model”. Autorja paraqiti punën e deritanishme për ndërtimin e një modeli të ri për politikën monetare në Bankën e Shqipërisë, të quajtur “Gap model”. Ky model përmban gjithsej katër ekuacione për PBB-në reale, për normën reale të interesit, për normën reale të kursit të këmbimit dhe për inflacionin. Të gjithë variablat paraqiten si devijime të tyre nga niveli ekuilibër dhe tek modeli gjendet një shkrimje e mirë midis karakteristikave të teorisë neo-keineziane me atë ciklit real të biznesit.

Një tjetër punim i paraqitur ishte ai me temë “Analiza e sistemit bankar shqiptar nën këndvështrimin rrezik - performancë”, me autore Irini Kalluci, Departamenti i Kërkimeve. Materiali trajton si teorikisht ashtu edhe në formën e një analize, tregues të rrezikut dhe të kthimit të sistemit bankar shqiptar. Për herë të parë, paraqitet edhe metodologjia e përlogaritjes së një indeksi rreziku për këtë sistem. Ajo çka synohet të arrihet nëpërmjet këtij punimi është jo thjesht analiza e treguesve të rrezikut dhe performancës, por mbi të gjitha sugjerimi i disa treguesve dhe i një indeksi që mund të përdoren nga mbikëqyrësit gjatë punës së tyre.

Prezantimi i fundit për këtë tremujor ishte ai i Ilir Vika, Departamenti i Kërkimeve mbi temën “Matja e ekuilibrit të kursit të këmbimit të lekut”. Studimi synon të masë ekuilibrin e kursit të këmbimit në Shqipëri, duke përdorur metodën e vlerësimit ARDL për kursin real të këmbimit të lekut kundrejt euros. Përcaktuesit e kursit ekuilibër të konsideruar në këtë studim përfshijnë diferencën e produktivitetit, mjetet e huaja neto, shpenzimet e qeverisë, diferencën e normave të interesit dhe shkallën e hapjes së ekonomisë.

II. PUNËT KËRKIMORE TË SAPOPUBLIKUARA

1. “INDEKSI I ÇMIMEVE/VLERAVE NJËSI TË HUAJA TË IMPORTEVE SHQIPTARE” RISAN SHLLAKU, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE.

(tekst i plotë)

Të dhënat dhe statistikat ekonomike janë elemente themelore për kryerjen e analizave të suksesshme ekonomike dhe për formulimin e politikave ekonomike, si nga sektori publik ashtu dhe nga ai privat. Në fakt, të dhënat dhe statistikat ekonomike i përmbushin të gjitha

kërkesat për t'u konsideruar një e mirë publike. Fatkeqësisht, cilësia e tyre në rastin e Shqipërisë nuk konsiderohet mjaft e kënaqshme për momentin. Duke pasur parasysh rëndësinë e të dhënave dhe të statistikave ekonomike, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë hapa konkretë në drejtim të përmirësimit të ndërtimit, besueshmërisë, disponueshmërisë dhe shpërndarjes së këtyre të dhënave.

Në këtë kontekst, indeksi i çmimeve/vlerave njësi të huaja të importeve shqiptare shënon një përpjekje tjetër të Bankës së Shqipërisë për përmirësimin e të dhënave dhe të statistikave ekonomike. Indeksi i parë i ndërtuar, përqendrohet vetëm në identifikimin e lëvizjeve të çmimeve të importeve shqiptare në tregjet nga të cilat importohen, por jo në efektin e kursit të këmbimit.

Një gjë e tillë, bën që efektet e lëvizjeve të çmimeve të importit në tregjet e huaja dhe ndryshimet në kursin e këmbimit mbi tregues të ndryshëm makroekonomikë me interes, për shembull mbi normën e inflacionit, të analizohen dhe të llogariten veçmas. Ky indeks është mjaft i rëndësishëm për rastin e Shqipërisë, duke pasur parasysh faktin se ekonomia shqiptare është e vogël dhe e hapur.

Është e qartë se llogaritja e një mesatareje të peshuar të ndryshimeve në IÇK -të e vendeve kryesore nga ku importon Shqipëria – e llogaritur në bazë të peshës së importeve nga secili vend – mund të shërbejë gjithashtu, si një alternativë zëvendësuese për këtë qëllim, ndonëse kjo e fundit mund të jetë disi e pasaktë dhe mund të mos përfaqësojë në mënyrë të drejtë lëvizjet e çmimeve të importeve shqiptare në

vendet e huaja. Përpjekje të tjera për ndërtimin e indekseve më përfaqësuese, mund ta përmbushin në mënyrë të kënaqshme kriterin e kostos dhe të përfitimit.

Materiali organizohet si vijon: Pjesa e dytë paraqet një përshkrim të shkurtër të teorisë së indekseve të numrave dhe të çështjeve kryesore, që lidhen me indekset e çmimeve. Pjesa e tretë paraqet një përfaqësim të bazuar në indekset e çmimeve/vlerave njësi të eksporteve të vendeve kryesore nga ku importon Shqipëria. Për shkak të mungesës së të dhënave, për disa vende përdoren indekset e çmimeve të eksporteve, ndërkohë për disa të tjera përdoren indekset e vlerave njësi të eksporteve. Në këtë pjesë, jepet gjithashtu një përshkrim i përparësive dhe i mangësive të kësaj përfaqësimi. Ndërkohë, pjesa e katërt jep përfundimet.

2. "ROLI I KURSIT TË KËMBIMIT NË SHËNJESTRIMIN E INFLACIONIT, SI VEPROHET?" ALTIN TANKU, ILIR VIKA DHE MARIAN GJERMENI, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE, DEPARTAMENTI I OPERACIONEVE MONETARE.

(tekst i plotë)

Ky material studimi analizon lidhjen ndërmjet kursit të këmbimit dhe inflacionit në Shqipëri. Qëllimi i parë është të shqyrtohet ndikimi i ndryshimeve të kursit të këmbimit në çmimet e konsumatorit vendas dhe së dyti, të hidhet dritë mbi rëndësinë e lëvizjeve të monedhës në drejtimin e politikës monetare. Gjetjet mund të jenë me vlerë

për politikëbërësit e bankës qendrore para adoptimit të plotë të regjimit të inflacionit të shënjestruar.

3. "MATJA E EFEKTIT BALASSA-SAMUELSON: RASTI I SHQIPËRISË", EVELINA ÇELIKU DHE RAINA HOXHOLLI, DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE.

(tekst i plotë)

Ky material synon të verifikojë praninë e efektit Balassa – Samuelson si dhe ta masë atë në rastin e ekonomisë shqiptare, gjatë periudhës 1998-2006. Eksplorimi i efektit Balassa-Samuelson, përbën një aspekt të rëndësishëm për politikën monetare të ndjekur nga bankat qendrore, sepse ai i vë theksin lidhjes midis produktivitetit relativ të sektorit të tregtueshëm të një ekonomie të vogël të hapur në terma të sektorit të patregtueshëm të saj, me çmimet relative të këtyre dy sektorëve. Teorikisht, prania e një lidhjeje pozitive do të mbështeste faktin që inflacioni ndikohet nga rritja e produktivitetit relativ.

Në këtë material, me ndihmën e modeleve ekonometrike, është vlerësuar efekti i brendshëm dhe i jashtëm Balassa-Samuelson mbi inflacionin.

Për kryerjen e vlerësimeve, u përdorën të dhënat e vlerës së shtuar dhe numrit të të punësuarve për gjashtë sektorë të ekonomisë. Nëpërmjet tyre u llogaritën përafrime të ndryshme për produktivitetin në sektorët e tregtueshëm dhe të patregtueshëm të ekonomisë. Përafrime të ndryshme për çmimet relative dhe klasifikime të ndryshme të sektorëve të

ekonomisë u ndërtuan për të testuar në mënyrë më të plotë efektin Balassa - Samuelson.

Rezultatet tregojnë se për periudhën e marrë në studim, ekziston një lidhje pozitive ndërmjet produktivitetit relativ dhe çmimeve relative, fakt që mbështet studimin e efektit Balassa – Samuelson në rastin e ekonomisë tonë. Vlerësimet sasiore dëshmojnë se ky efekt ka patur një ndikim të moderuar mbi inflacionin.

Materiali paraqet edhe rezultatet e një modelimi më specifik të këtij efekti mbi tendencat e kursit real të këmbimit. Përfundimet e analizës së kointegritimit ndërmjet REER dhe ndryshimit të produktiveteve relative, tregojnë se në periudhën afagjatë, implikimet janë më të dukshme mbi REER. Vlerësohet se goditje vetëm nga diferencat në produktivete çekuilibrojnë REER, i cili mund të rivendoset në gjendje ekuilibri pas një periudhe relativisht të gjatë, 2 vite.

Rezultatet e studimit ndihmojnë në eksplorimin më të detajuar të modelit të ekuilibrit të përgjithshëm të kursit të këmbimit në Shqipëri.

4. "ROLI I BANKAVE NË TRANSMETIMIN E POLITIKËS MONETARE NË SHQIPËRI", ILIR VIKA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE.

(tekst i plotë)

Ky studim kontribuon me gjetjen e evidencave empirike mbi kanalin e kredisë

bankare të politikës monetare në Shqipëri duke përdorur të dhënat individuale të 12 bankave kryesore.

Në veçanti, synohet të studiohet nëse ecuria e kredisë bankare ndaj sektorit privat mund të shpjegohet nga ndryshimet në treguesin e politikës monetare, i matur me normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes njëjavore. Gjetjet empirike sugjerojnë se për periudhën 2004-2006 sjellja e kredisë bankare është ndikuar në mënyrë modeste nga vendimet e politikës monetare. Koeficientët e treguesit të politikës monetare janë statistikisht të rëndësishëm dhe me shenjë negative, që mbështet lidhjen teorike midis normës së interesit dhe vëllimit të kredisë.

Megjithatë, evidencat empirike për të mbështetur ekzistencën e një kanali të kredisë bankare në Shqipëri janë mikse. Në kundërshtim me teorinë dhe pritjet intuitive në vend, rezultatet e nxjerra tregojnë se bankat e vogla janë më pak të ndjeshme ndaj qëndrimit të politikës monetare se sa ato më të mëdha. Ndërkohë, bankat me likuiditet më të madh duket se janë më të mbrojtura ndaj ndryshimeve të politikës monetare, në linjë me teorinë mbi kanalin e kredisë bankare.

5. "AËSHTË I QËNDRUESHËM DEFICITI I LLOGARISË KORENTE? RASTI I SHQIPËRISË.", ALTIN TANKU, EVIS RUÇAJ, ARGITA FRASHËRI, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE, DEPARTAMENTI I STATISTIKAVE.

(tekst i plotë)

Gjatë 15 viteve të fundit, llogaria korente e Shqipërisë ka kaluar në deficite të cilat në shumicën e rasteve kanë shkuar përtej 5 për qind të PBB-së, një nivel qëndrueshmërie i pranuar gjerësisht. Ky studim trajton aftësitë e qëndrueshmërisë së deficitit të llogarisë korente, duke u bazuar mbi metodën LRBC të zhvilluar nga Trehan dhe Walsh (1991) dhe të zgjeruar nga Taylor (2002). Ne kemi marrë në shqyrtim vërtetime tremujore të llogarisë korente për periudhën 1994–2006 dhe testimin e rrënjës së njësisë, për të shqyrtuar qëndrueshmërinë e llogarisë korente. Vëmendje të veçantë i kemi kushtuar rolit të remitancave dhe synojmë të vlerësojmë nëse ato luajnë ndonjë rol të konsiderueshëm në qëndrueshmërinë e llogarisë korente. Rezultatet tona tregojnë se pavarësisht zgjerimit të deficitit kohët e fundit, duket se llogaria korente në periudhën afatgjatë është e qëndrueshme. Megjithatë, kjo qëndrueshmëri mund të jetë e cënueshme, ndaj meriton vëmendjen e autoriteteve shqiptare.

III. ARTIKUJ DHE MATERIALE DISKUTIMI NË PROCES

Në Bankën e Shqipërisë, në këtë periudhë, po punohet mbi argumentet e mëposhtme.

1. "NDIKIMI I STOKUT DHE FLUKSIT TË AKTIVEVE NË EKUILIBRIN E KURSIT REAL TË KËMBIMIT NË SHQIPËRI", ILIR VIKA.

Ky studim bën një vlerësim të ekuilibrit të kursit real të këmbimit, duke u bazuar në ndikimin e stokut dhe fluksit të aktiveve mbi të, një përjasje kjo e përdorur gjerësisht nga literatura si për ekonominë e industrializuar, ashtu dhe për ato të Evropës Lindore. Përmes metodës ARDL, autori përpiket të identifikojë faktorët afatgjatë që përcaktojnë kursin real të këmbimit lek/euro. Në fillim, bëhet vlerësimi i lidhjes së IÇK-së duke marrë për bazë kursin real të këmbimit, diferencës në produktivitet dhe mjeteve valutore neto për periudhën 1999T1 - 2008T4.

Për kontrollin e vlefshmërisë së rezultateve, formës së shkurtuar të ekuacionit më vonë i shtohen disa variabla të tjerë, të cilët përfshijnë shpenzimet qeveritare, kushtet e tregtisë, hapjen ekonomike dhe borxhin publik. Shpesh, konsumi publik përdoret për shpjegimin e faktorëve të kërkesës, të cilët mund të ndryshojnë çmimin relativ të mallrave të patregtueshëm e për rrjedhojë, të shkaktojnë luhatje të kursit real të këmbimit.

Normalisht, një përmirësim i përgjithshëm në kushtet e tregtisë në Shqipëri çon në vlerësimin real të monedhës vendase. Hapja ekonomike mund të konsiderohet si një përbërës kalimtar i dinamikës së kursit real të këmbimit, duke qenë se një ekonomi me rritje të plotë përjeton luhatje të kufizuara në totalin e tregtisë së saj në përqindje të PBB-së.

Në rastin e Shqipërisë, rritja e hapjes ekonomike si rezultat i liberalizimit të tregtisë pritet të përkeqësojë pozicionin e llogarisë korente, duke nënvlerësuar

kështu kursin real të këmbimit. Për shkak të mungesës së të dhënave, primi i rrezikut të vendit përafrohet duke përdorur raportin e borxhit publik me PBB-në. Një borxh publik në rritje shpesh perceptohet si rrezik më i lartë, duke ulur kështu dëshirën për të mbajtur sasi më të mëdha nga valuta e atij vendi.

Gjetjet paraprake sugjerojnë se gjatë periudhës 1999T1:2008T4, kursi real i këmbimit lek/euro ka qenë më i ndjeshëm ndaj diferencës në produktivitet dhe më pak ndaj mjeteve valutore neto. Gjithashtu, koeficientët përpara variablave të tjerë kontrollues janë përgjithësisht statistikisht të parëndësishëm ose madje, mund të kenë shenja të paparashikuara.

2. "ANALIZA STRESS-TEST E RREZIKUT TË TËRTHORTË TË KREDISË NË SHQIPËRI, BAZUAR NË KARAKTERISTIKAT INDIVIDUALE TË BANKAVE", HILDA SHIJAKU DHE KLITI CECA.

Qëllimi kryesor i këtij materiali është vlerësimi i rrezikut të tërthortë të kredisë, me të cilin përballen grupe të ndryshme bankash dhe jo i tërë sistemi bankar.

Ky material, shqyrton reagimin e raportit të huave me probleme ndaj kushteve makroekonomike, të cilat përkeqësojnë aftësinë paguese të huamarrësve përmes kanaleve të rrezikut të kredisë, bazuar në karakteristikat individuale të bankave, siç janë madhësia e tyre, pronësia,

kapitalizimi dhe veçori të tjera të portofolit të kredisë.

Modelimi empirik bëhet i mundur përmes vlerësimit në grup të të dhënave të bankave, që operojnë në Shqipëri. Ai do të përbente një vlerë të shtuar në vlerësimin e koeficientëve të përdorur për analizën stress-test për banka individuale.

Ky studim është gjithashtu i nevojshëm për identifikimin e zërave të ndjeshëm në bilancin e bankave, në rastin e aplikimit të skenarëve të ndryshëm, veçanërisht nisur nga mungesa e diversifikimit të portofolit të bankave në Shqipëri.

3. "RRITJA E KREDITIMIT NË SHQIPËRI; A NDODHET AI NË NIVELIN EKUILIBËR?", IRINI KALLUCI.

Ky studim ka për qëllim kryesor vlerësimin e ecurisë së rritjes së kreditimit në Shqipëri dhe përcaktimin nëse ai ka arritur nivelin e tij ekuilibër. Rezultatet e këtij vlerësimi janë veçanërisht të nevojshme në rastin e Shqipërisë, duke patur parasysh normat e larta të rritjes së kreditimit gjatë viteve të fundit.

Shumë shpejt, këto studime do të diskutohen në grupin e ekspertëve, opinioni i të cilëve shpesh ka qenë ndihmesë për autorët.

V. TË NDRYSHME

Banka e Shqipërisë ka njoftuar **Konferencën e saj të 8 Ndërkombëtare me temë: "Politika të stabilitetit monetar dhe financiar – leksione nga kriza"**.
(tekst i plotë)

Ajo do të zhvillohet në Tiranë, në datat 17-18 shtator. Janë ftuar të marrin pjesë rreth 250 përfaqësues të bankave qendrore, të rretheve akademike e të institucioneve të ndryshme financiare e studimore brenda e jashtë vendit. E konceptuar me tre panele diskutimi, konferenca do të përpiqet të trajtojë çështje shumë të rëndësishme të momentit siç është kriza financiare globale dhe efektet e saj. Në dy panelet e para, të ftuarit nga bota akademike, bankare e financiare ndërkombëtare do të analizojnë krizën me të gjitha

elementet e saj përbërëse si dhe ndikimin që ka patur ajo në ekonominë e Evropës Juglindore. Paneli i tretë do të mbledhë në një tryezë të përbashkët Guvernatorët dhe Zëvendësguvernatorët e bankave qendrore të rajonit, të cilët do të diskutojnë rreth qëndrimeve, masave dhe eksperiencave të tyre në situatën e krizës.

Banka e Shqipërisë ka shpallur edhe për këtë vit konkursin për **"Çmimin e Guvernatorit për Diplomën më të mirë"**.
(tekst i plotë)

Janë ftuar si edhe vitet e tjera, të marrin pjesë studentët shqiptarë të diplomuar gjatë këtij viti akademik, brenda dhe jashtë vendit. Temat që pranohen duhet të jenë të zhvilluara

mbi çështje të lidhura me ekonomiksmonetar, stabilitetin financiar, integrimin ekonomik të Ballkanit në Evropë, veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, sistemin bankar shqiptar dhe ekonominë në përgjithësi. Afati i pranimi të tyre shkon deri në datën 1 shtator 2009, pas të cilës komiteti shkencor fillon të marrë në shqyrtim temat e paraqitura.

Takimi i tretë rajonal: “Kërkimet Ekonomike në Evropën Juglindore”.
(tekst i plotë)

Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Bankën e Greqisë do të organizojnë në Athinë, 19-21 nëntor 2009, takimin e tretë rajonal **“Kërkimet Ekonomike**

në Evropën Juglindore”. Në këtë tryezë të rrumbullakët të këmbimit të ideve e përvojave do të marrin pjesë rreth 30 diskutantë nga vende të rajonit por edhe më gjerë.

Diskutimet në takim do të fokusohen mbi tre çështje kryesore shumë të rëndësishme për bankat qendrore të vendeve në tranzicion dhe ekonomive të vogla e të hapura në SEE:

1. stabiliteti ekonomik dhe financiar;
2. banking dhe financë;
3. zhbancimet e brendshme dhe të jashtme.

LINQE:**PUNË KËRKIMORE TË BANKAVE TË TJERA QENDRORE**

European Central Bank (<http://www.ecb.int/home/html/researcher.en.html>)

Bank of Greece (<http://eng.bankofgreece.gr/en/publications/research.asp>)

Deutsche Bundesbank (http://www.bundesbank.de/vfz/vfz_diskussionspapiere_2009.en.php)

Oesterreichische Nationalbank (http://www.oenb.at/en/presse_pub/research/research.jsp)

Banca d'Italia (<http://www.bancaditalia.it/studicerche>)

Czech National Bank (<http://www.cnb.cz/en/research/>)

Banco de Espana (<http://www.bde.es/informes/be/docs/docse.htm>)

Bank of Finland (http://www.bof.fi/en/julkaisut/bofit_julkaisut/index.htm)

Bank of England (<http://www.bankofengland.co.uk/publications/workingpapers/index.htm>)

Federal Reserve (<http://www.federalreserve.gov/econresdata/default.htm>)

TË TJERA

BIS Central Bank Research Hub (<http://www.bis.org/cbhub/index.htm>)

International Journal of Central Banking (<http://www.ijcb.org/>)

National Bureau of Economic Research (<http://www.nber.org/>)

International Monetary Fund (<http://www.imf.org/external/pubind.htm>)

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.

Botuar nga: Banka e Shqipërisë, sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.

Tel: 355-4-2222230; 2222152; 2235569.

Faks: 355-4-2223558.

E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 500 kopje.